

**UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR**



PUNIM DIPLOME

Xhenete Haziri

Mitrovicë,2021

**UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR**



PUNIM DIPLOME

**VEÇORI TË FIGURAVE STILISTIKE PËR
FËMIJË**

Mentori:

Prof.Ass.Dr Violetë Bardhi-Zeqiri

Kandidatja:

Xhenete Haziri

Mitrovicë,2021

**UNIVERSITY “ISA BOLETINI”
FACULTY OF EDUCATION
PRIMARY PROGRAM**



BACHELOR THESIS

FEATURES OF STYLISTIC FIGURES FOR CHILDREN

Thesis Supervisor:

Prof.Ass.Dr Violetë Bardhi-Zeqiri

Candidate:

Xhenete Haziri

Mitrovicë,2021

**UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR**



PUNIM DIPLOME

Lënda: Letërsi për fëmijë

Titulli i punimit: Veçori të figurave stilistike për fëmijë

Emri dhe mbiemri: Xhenete Haziri

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 1606011106

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentorja e punimit: Prof.Ass.Dr Violetë Bardhi-Frangu

Aprovuar prej komisionit:

1. _____,mentor
/Emri Mbiemri, Titulli/
2. _____,anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli/
3. _____,anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli/

Data e aprovimit

Deklarata e autorësisë

Unë Xhenete Haziri, e lindur më 07.01.1995 në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë, si studente e bachelorit në Universitetin e Mitrovicës, para mbrojtjes së punimit të bachelorit, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim i bachelorit me titull: “Veçori të figurave stilistike për fëmijë” është punuar prej meje. Punimi nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi në tërësi u përmbahet rregullave për plagjiaturë. Punimi, nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara. Andaj vetëm unë mbaj përgjegjësi personale deri në anulim të titullit të fituar në bazë të mbrojtjes së këtij punimi. Përgjegjësinë për plagjiaturë në asnjë formë nuk mbajnë institucioni dhe antarët e komisionit. Deklaratën e nënshkruaj në prezencë të referentës së shkallës së tretë.

Mitrovicë, 2021

Nënshkrimi i kandidatës:

Falënderime

Së pari, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për mentoren time Prof. Violetë Bardhi-Zeqiri për për ndihmën, këshillat, sygjërimet e saj të vlefshme, udhëzimet dhe mbështetjen e saj akademike gjatë realizimit të temës, ku gjatë procesit të hulumtimit dhe punimit të kësaj teme, qëndrimi i saj pozitiv dhe inkurajues më ndihmoi shumë.

Falënderoj poashtu të gjithë profesorët e Fakultetit të Edukimit për ligjëratat e vjera gjatë studimeve dhe u jam mirënjohëse që mundësuan një qasje bashkëkohore të studimeve.

Një falënderim shumë të madh do ia dedikoj familjes sime ,prindërve të mi të cilët më ndihmuan dhe më dhanë mbështetje shumë të madhe në shkollimin dhe ngritjen time akademike.

Poashtu, i jam mirënjohëse shkollës fillore dhe të mesme të ulët “ Ali Kelmendi” në Vushtrri që më mundësoi realizimin e hulumtimit duke u bërë pjesë e hulumtimit tim me përgjigjet e tyre.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	I
FALËNDERIME	II
PËRMBAJTJA	III
LISTA E GRAFIKËVE	IV
ABSTRAKT	V
ABSTRACT	VI
1.HYRJE.....	1
1.1 LETËRSIA PËR FËMIJË	2
1.1.1.PERIODIZIMI I LETËRSISË PËR FËMIJË	3
1.2.VEÇORI TË FIGURAVE STILISTIKE	4
1.2.1.HIPERBOLA	9
1.2.2.KRAHASIMI.....	10
1.2.3.PERSONIFIKIMI.....	12
1.2.4.EPITETI	13
1.2.5.ONOMATOPEJA.....	14
1.2.6.SIMBOLI	15
1.2.7.METAFORA	16
2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	18
2.1 DIZAJNI HULUMTUES.....	18
2.2.PJESËMARRËSIT	18
2.3 PYETJET E HULUMTIMIT	18
2.4.INSTRUMENTET	18
2.5.MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE	18
2.6 ANALIZAT	19
2.7.ASPEKTI ETIK	19
2.8.KUFIZIMET E HULUMTIMIT	19
3.REZULTATET E HULUMTIMIT	20
4.DISKUTIME.....	25
5.PËRFUNDIME	26
6.REKOMANDIME	27
LITERATURA	28
SHTOJCA.....	29
PYETËSOR –	29

LISTA E GRAFIKËVE

- Grafiku 1. *Cilat nga figurat stilistike i njihni?*..... f.14
- Grafiku 2. *Si arrini t'i dalloni figurat stilistike?*..... f.14
- Grafiku 3. *Si keni arritur t'i përvetësoni këto figura?*..... f.15
- Grafiku 4. *Sa interesante iu duken figurat stilistike?*..... f.15
- Grafiku 5. *Në vargun: mjau, mjau macja bënte,kemi këtë figurë :*..... f.16
- Grafiku 6. *është figura stilistike,me anë të së cilës sendit apo kafshës i vishen tiparet e njeriut ,gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz.*
-----f.16
- Grafiku 7. *Syni i saj si kokrra e qershisë.Këtu kemi të bëjmë me:-----f.17*
- Grafiku 8. *Kam kaluar shtatë bjeshkë për të ardhur gjer këtu.*
Skënderbeu rrëmbeu shpatën sikur të ishte një pend.
Këtu bëhet fjalë për :..... f.17
- Grafiku 9. *Cilat figurat stilistike i pëlqejnë më shumë?*..... f.18

ABSTRAKT

Objekt studimi në këtë temë kanë qenë veçoritë e figurave stilistike, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në letërsinë për fëmijë. Edhe pse mund të jetë e vështirë për fëmijët t'i kuptojnë këto figura për shkak të nivelit të tyre intelektual, këto figura gjejnë përdorim të madh në veprat e shkrimtarëve që janë posaçërisht për grupmoshat e vogla, megjithëse përpjekjet e shkrimtarëve janë bërë që këto figura të bëhen sa më të përshtatshme për mendjen e tyre dhe si ata mund t'i përvetësojnë ato lehtë.

Për të parë se sa nxënësit kanë njohuri për këto figura është realizuar një hulumtim i tipit sasior dhe i cili është realizuar në Shkollën fillore "Ali Kelmendi" në Vushtri.

Hulumtimi ka konsistuar në pyetësor që përmban pyetje lidhur me studimin në fjalë dhe popullacion do të jenë nxënësit e klasave të V-ta. Në këtë punim janë të përfshira tri klasë të V-ta, përkatësisht klasa V-1, V-2 dhe V-3. Mirëpo për shkak të situatës me Covid-19 në vend, mësimi po realizohet në dy grupe, kështu që në pamundësi për të përfshirë sa më shumë nxënës, hulumtimi është realizuar vetëm me grupet e dyta, pra ato që mësimin e fillojnë pasdite. Mostra totale e këtij hulumtimi është 40 nxënës të cilët janë zgjedhur sipas mostrës së rastësishme. Rezultatet e hulumtimit paraqesin figurat stilistike që nxënësit i njohin, si kanë arritur t'i përvetësojnë këto figura me anë të shpjegimeve, sqarimeve dhe bashkëpunimit me mësuesen. Poashtu, nxënësit janë mesatarisht të interesuar për t'i mësuar këto figura. Në pyetësor poashtu ka pasur pyetje lidhur me përmbajtjen e këtyre figurave dhe sa ata arrijnë t'i dallojnë përmes shembujve. Si përfundim, nga ky hulumtim rezulton se hiperbola, krahasimi, personifikimi dhe onomatopeja janë më të pëlqyerat për ta.

Fjalët kyçe: Figura stilistike, onomatope, hiperbolë, metaforë

ABSTRACT

The object of study in this topic have been the features of stylistic figures, which play a very important role in children's literature. Although it may be difficult for children to understand these figures because of their intellectual level, these figures find great use in the works of writers that are specifically for the younger age groups, although the efforts of writers have been made to make these figures as appropriate as possible to their mind and how they can assimilate them easily.

To see how much students know about these figures, a quantitative research was conducted at the “Ali Kelmendi” Primary School in Vushtrri.

The research consisted of a questionnaire containing questions related to the study in question and the population will be 5th grade students. In this paper are included three 5th grade, respectively grades V-1, V-2 and V -3. But due to the situation with Covid-19 in the country, teaching is carried out in two groups, so unable to include as many students, the research was conducted only with the second groups, ie those who start teaching in the afternoon .The total sample of this research is 40 students who were selected according to a random sample. The results of the research present the stylistic figures that the students know, how they managed to acquire these figures through explanations, clarifications and cooperation with the teacher. Also, the students are moderately interested in learning these figures. There were also questions in the questionnaire. regarding the content of these figures and how much they manage to distinguish them through examples. In conclusion, from this research it results that hyperbole, comparison, personification and onomatopoeia are the most popular for them.

Keywords: Stylistic figure, onomatopoeia, hyperbole, metaphor

1.HYRJE

Është dëshmuar se letërsia për fëmijë zë një vend të rëndësishëm në letërsinë tonë.Me atë kuptojmë tregimet, vjershat, përrallat, fabulat si dhe tërë veprimtarinë që është shkruar posaçërisht për të vegjlit.

Letërsia është dije,ndaj pushteti i dijes i artikuluar artistikisht ndjehet nga fëmija.Thuajse në të gjitha krijimet për fëmijë,qofshin ato poezi a prozë dominon figura e fëmijës.Këtë e dëshmojnë edhe krijimet e traditës edhe ata bashkëkohorë.Që nga Naimi, me të cilin edhe fillon letërsia artistike shqipe për fëmijë,ajo vazhdon me autorë të tjerë të cilët në qendër të krijimeve të tyre letrare i kanë fëmijët dhe preokupimet e tyre.Lexuesit e vegjël në krijimet dedikuar atyre kërkojnë ta gjejnë veten, ata i tërheq bota e lojërave,mrekullitë, dëshira për të pamundshmen, vizioni simbolik i botës, kontaktet e para me botën, kureshtja, dëfrimi, miqësia, dashuria prindërore etj.) Me një fjalë, atyre u intereson çdo gjë që ndodh rreth tyre, pra, tematika interesante dhe bota e zbuluar me anë të imagjinatës, sepse mosha e tyre e vogël s'është e përgatitur ta pranojë të vërtetën si të tillë.Ata i tërheq realiteti i poetizuar, realiteti metaforik i pikturuar me ngjyra të kulluara dhe të qarta.¹

Megjithatë, ka keqkuptime sa i përket emërimit të saj ose përdorimit të termit,ku në jetën e përditshme hasim në emërtime të ndryshme,duke filluar nga termi letërsi fëmijore ose letërsi e fëmijëve i cili nuk është i saktë, sepse me këtë koncept duhet të kuptojmë krijimtarinë letrare që shkruhet nga vetë vocrrakët, krijimtari që nuk e ka nivelin e duhur artistik.Kurse ne e kemi fjalën për atë krijimtari letrare që shkruhet nga të rriturit dhe që u kushtohet fëmijëve.Ka edhe një keqkuptim tjetër ku shkrimtarët shpesh rrokin tema të frymëzuara nga fëmijëria e tyre ose shkruajnë pjesë ku personazhet vepruese janë fëmijë.Në këtë rast krijimet e tyre janë mbi fëmijët. Këto krijime janë shkruar për lexuesin e rritur dhe mund të mos u përshtaten dhe të mos u pëlqejnë lexuesve të vegjël.Pra, nuk mjafton vetëm tema dhe mosha e personazheve (ata mund të jenë edhe të rritur e pleq) për të dhënë krijime të vlefshme për fëmijët.²

¹ <https://tradita.org/2020/02/14/rrjedhave-te-letersise-bashkekohore-shqipe-per-femije/>

² Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.12,13

1.1 LETËRSIA PËR FËMIJË

Letërsia për fëmijë është dukuri e Definicione për letërsinë për fëmijë ka shumë. Të gjitha thuajse janë të përafërta dhe të gjitha vlerësojnë se përkufizimi i kësaj letërsie është shumë i vështirë. Megjithatë, definicioni që në një mënyrë është më gjithëpërfshirës mund të tingëllonte kështu: letërsia për fëmijë është letërsia që dallon nga letërsia për të rritur, shkaku i shtresave të theksuara psikologjike e pedagogjike të saj, krahas spektrit tematik, që nuk e ka letërsia për të rritur, siç është loja, humorit, fantastikja, spontaniteti etj. Ajo çka e dallon letërsinë e fëmijëve nga ajo për të rritur është pikërisht kriteri i moshës.³ Mirëpo, kjo nuk nënkupton që kjo letërsi lexohet vetëm nga të vegjëlit, sepse ajo shpesh ka edhe lexues të moshave të pjekura, të cilët dëshirojnë të përjetojnë sërish ndjenjat e të qenurit fëmijë, sepse Bjelinski thoshte se letërsi e vërtetë për fëmijë është ajo që e lexon me kënaqësi jo vetëm fëmija, po edhe njeriu i burrëruar dhe plaku.

Klasifikimi i letërsisë për fëmijë udhëhiqet nga kritere të ndryshme e të shumta, shpeshherë të diskutueshme, sepse kategorizimi i saj ka të bëjë me audiencë të veçantë, e cila natyrisht nuk është homogjene për faktin se fëmijët mund të jenë të ndryshëm për nga pjekuria e tyre emocionale dhe përgatitja arsimore, edukata e kultura e përgjithshme dhe ajo familjare.

Bazuar në idetë për të përcaktuar letërsinë për fëmijë, kjo letërsi është vlerësuar si letërsi që njëkohësisht bazohet në dy sisteme: në sistemin *letrar* dhe në sistemin *pedagogjik*.

Natyrisht, shumica e teorikëve mbështeten fuqishëm edhe në vlerat e socializimit që duhet t'i ketë ky art, në ato arsimore e kulturore, vlera që i atribuohen këtij zhanri të letërsisë.

Letërsia është dije, ndaj pushteti i dijes i artikuluar artistikisht ndjehet nga fëmija. Këto veçori të këtij zhanri në letërsinë shqipe për fëmijë i hasim ku të shpërndara e ku më të njësuara.

Veçori të përgjithshme, që duhen hetuar në letërsinë për fëmijë, mund të konsiderohen këto:

- Karakteret kryesore gjithsesi duhet të jenë fëmijët;
- Tematikisht vepra të përshtatet me moshën dhe aftësitë psikofizike të fëmijës;
- Vepra me pak tekst e me shumë foto, sidomos për moshat e vogla;
- Më shumë dialog, më pak përshkrime;
- Ndërtohet mbi aventurat e heronjve-fëmijë;
- Kanë përfundim kryesisht fatlum (e mira e mund të keqen, ngjashëm si në përralla);
- Letërsi që ka karakter edukativ, njohës, përveçse estetik;
- Përsëritja dhe shpjegimet janë më të shpeshta, shkaku i moshës së lexuesit;
- Karakteri interaktiv për të ndihmuar zhvillimin e fëmijës;
- Përgatit fëmijët për jetë dhe për situata të ndryshme në jetë.⁴

³ Qibrije Demiri-Frangu, Letërsia për fëmijë, Prishtinë, f.13

⁴ Po aty, f.16

1.1.1.Periodizimi i letërsisë për fëmijë

Janë bërë tri tentativa për periodizimin e letërsisë së fëmijëve,përkatësisht në vitin 1971,1983 dhe1985.Mirëpo periodizimi i parë është bërë nga Bedri Dedja dhe Gjergj Zheja.

Bedri Dedja e ndan historinë e letërsisë në katër periudha:

- 1) Burimet e letërsisë për fëmijë (folklori për të vegjël) ku hyjnë: përrallat,gojëdhënat, ninullat, këngët legjendare, gjëegjëzat, anekdotat, përrallëzat dhe fjalët e urta.
- 2) Periudha e dytë – veprat didaktike- Naim Frashëri
- 3) Periudhae luftës antifashiste – Çajupi
- 4) Periudha e realizmit – Migjeni.

Sipas periodizimit të moshave,veprat e letërsisë për fëmijë mund të ndahen në tri grupe kryesore:⁵

- a) Veprat e letërsisë për moshën parashkollore,nga 3 deri më 6 vjeç (për fëmijët e kopshteve);
- b) Veprat e letërsisë për shkollarët e vegjël,nga mosha 6-7 gjer më 11-12 vjeç(kryesisht për fëmijët e klasave I-V të shkollës nëntëvjeçare);
- c) Veprat e letërsisë për shkollarët e rritur,që nga 11-12 gjer më 15-16 vjeç(për fëmijët e klasave VI-IX të shkollës nëntëvjeçare.

Në një shikim më të imët,mosha shkollore(arsimi nëntëvjeçar) në disa raste është ndarë jo në dy,por në tri nëndarje:

Shkollarët e vegjël,nga mosha 6-7 gjer 9-10 vjeç (kl.1-3)

Shkollarët e mesëm,nga 9-10 gjer 12-13 vjeç (kl.4-6)

Shkollarët e rritur ,nga mosha 12-13 gjer 15-16 (kl.7-9)

Por, megjithëse periodizimi mbetet një çështje e hapur, ashtu si edhe nevoja për rishikimin e kësaj letërsie (sidomos e fazës moniste), si dhe transformimi i saj tematik e stilistik pas rënies së monizmit, sipas ndarjes së mëhershme, kjo letërsi mund të klasifikohet kështu:

- a) letërsia gojore,
- b) letërsia didaktike-mësimore,
- c) letërsia e shek.XIX si letërsi artistike (nga Rilindja deri në Luftën e Dytë Botërore), si dhe faza IV
- d) letërsia realiste apo edhe postmoderne.

Kjo ndarje kap periudha të gjata kohore, prandaj do të mund të bëhen edhe nëndarje e specifikime të tjera (po e zëmë letërsia e krijuar gjatë Rilindjes hyn bashkë me letërsinë e krijuar deri më 1939), ose ajo e fazës së katërt (fillon më 1939 për të vazhduar deri në vitet

⁵ Astrit Bishqemi,Teoria e letërsisë për fëmijë,Elbasan,2004,f.17

e fundit të monizmit -1990). Brenda këtij periodizimi global identifikohen rrjedhat e kësaj letërsie, prurjet si dhe veçoritë tematike e stilistike.⁶

1.2.VEÇORI TË FIGURAVE STILISTIKE

Gjuha ka mundësi të mëdha shprehëse.Me nuancat e shprehjes së saj merret një disiplinë e veçantë shkencore që quhet stilistikë.

Ajo ndahet në dy degë: në stilistikë gjuhësore dhe në stilistikë letrare.

Meqë çdo autor ka mënyrën e vet të përdorimit të gjuhës, ka modelet e tij të shprehjes, themi se ai ka stilin e tij (nga gr.stylos: një shkop metali,kocke ose fildishi me të cilin shkruhej mbi dërrasa të veshura me dyllë). Pra, stili ndryshon nga njëri autor te tjetri në nuanca më të vogla, por ndryshon shumë nëpër periudha të ndryshme letrare e artistike. Në procesin krijues poetët dhe prozatorët shpesh fjalëve u japin kuptime të reja, më të gjera dhe kuptime figurative. Këto kuptime të reja, kuptime figurative të fjalëve, quhen figura stilistike. Figura stilistike është një organizim i tillë gjuhësor, në të cilin fjalët marrin kuptime të dyta, do të thotë të figurshme, me figurat thuhet diçka që ose nuk mund të shprehet me mjete të tjera.

Figurat nuk janë një zbulim i jashtëm.Aristoteli mendonte se, ashtu siç nuk duhet ta tepërojë njeriu në pije, në ushqim etj., as poeti nuk duhet ta tepërojë në përdorimin e mjeteve shprehëse, me çka ai proklamonte parimin estetik të masës, të proporcionit e të harmonisë.⁷

Edhe dijetari romak Kuintiliani kërkonte përdorimin me masë të figurave stilistike.Stilin e stolitur me epitete të shumta, fjala vjen, ai e krahasonte me ushtrinë që ka karroca e kuaj po aq sa ka ushtarë.⁸

Figurat Stilistike, sipas një grupi studiuesish, ndahen në :

1. Figurat e kuptimit:

- ***antiteza***, - vënia ballë për ballë e dy cilësive, dy portreteve, dy tablove, dy ideve, dy forcave shoqërore të kundërta për të theksuar e vlerësuar ato për ta bërë sa më shprehës dhe emocional rrëfimin poetik.
- ***grotesku***, -është mënyrë shprehjeje ose mënyrë paraqitjeje në të cilën bashkohen anë të stërmadhuara të vëna në kontrast të fortë e të papritur, ose format më të përziera të parregullta e të largëta të realitetit duke i shformuar deri në përleshje
- ***hiperbola***, të zmadhuarit ose të zvogëluarit së tepërmi të cilësive dhe të veprimeve e njerëzve ose të dukurive të natyrës për të nxjerrë në pah një ide, një mendim, një cilësi, si dhe për të shprehur më me forcë qëndrimin emocional ndaj jetës që pasqyrohet.

⁶ Qibrije Demiri-Frangu, Letërsia për fëmijë,Prishtinë, f.22

⁷ Agim Vinca, Panteoni i ideve letrare. “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002, f.50

⁸ Po aty,f.68

- **ironia**, - është pohimi i diçkaje për të nënkuptuar të kundërtën e saj, thënia me seriozitet për të nënkuptuar talljen, përqeshjen, shprehja e dashurisë për të nënkuptuar urrejtjen.
- **kontrasti**, - ndërtohet duke vënë përballë në mënyrë të theksuar dy karaktere njerëzore, dy sende a dukuri, por duke kundërvënë figura a tablo të tjera, jo anë të veçanta, sit e antiteza
- **krahasimi**, - është të përshkruarit, të karakterizuarit dhe të vlerësuarit e një sendi, frymori a dukurie me anën e një sendi, frymori a dukurie tjetër më të njohur, me të cilën ka lidhje ngjashmërie.
- **litota**, - e kundërta e hiperbolës. Zvogëlon tepër dukurinë, tiparin, veprimin apo ngjarjen.
- **paradoksi**, - është një mendim origjinal i krijuesit që bie ndesh apo në kundërshtim me mendimet e përgjithshme.
- **paralelizmi figurativ**, është pranë vënia paralelisht e një dukurie të natyrës me një gjendje shpirtërore ose veprimi njerëzor, me qëllim që të theksohen e të shprehen gjallërisht veçoritë e jetës së njeriut.
- **personifikimi**, - është ajo figurë letrare stilistike me anën e së cilës sendit ose kafshës i vishen tiparet e njeriut, gjërat pa shpirt shpirtëzohen, gjërat pa ndërgjegje ndjejnë, mendojnë dhe kryejnë veprime njerëzore
- **sarkazmi**, - shkalla më e lartë. Denoncon, demaskon dhe godet, por bën edhe përgjithësime.
- **satira** - një shkallë më lart se ironia. Ajo denoncon dhe demaskon.
- **simboli**, - është ajo figurë stilistike, që tregon një send i cili të kujton një send tjetër, që ka njëfarë ngjashmërie.

2. Figurat e shqiptimit poetik (figurat tingullore dhe të intonacionit):

- **aliteracioni**, - përsëritja e zanoreve në të njëjtin varg.
- **anafora**, - përsëritja e së njëjtës fjalë në fillim të disa vargjeve
- **apostrofa**, - është ndërhyrje emocionale me anën e së cilës thërrasim pranë gjërat e largëta ose të afërta, të gjalla ose të vdekura, që ti bëjmë të pranishme, konkrete dhe që të ndikojmë kështu në ndjenjat dhe emocionet e të tjerëve.
- **asonanca (zanorësia)**, - përsëritja e bashkëtingëlloreve në të njëjtin varg.
- **epanalepsa**, - kemi kur një fjalë a shprehje e fillimit të një vargu përsëritet në fund të atij vargu.
- **epanastrofeja**, - kur një ose disa fjalë të fundit të vargut a të një fjalisë përsëriten në fillim të vargut a fjalisë që pason.
- **epifora**, - përsëritja e së njëjtës fjalë në fund të disa vargjeve.
- **konsonanca (bashkëtingëllorësia)**, - togje bashkëtingëlloresh, të përsëritura në vargje dhe strofa.
- **onomatopeja**, - është figurë stilistike e përsëritjes. Ajo ka në bazë imitimin e zhurmave dhe të zërave të natyrës, qenieve të gjalla etj.
- **paronomaza**, - është figurë stilistike që krijohet duke vënë afër në një fjali ose në një varg dy fjalë me përbërje tingujsh të ngjashëm, por me kuptim të ndryshëm.

- **pasthirrma**, - veçimi i diçkaje për ta theksuar më tepër, duke shprehur në këtë rast një ndërhyrje emocionale në formën e një thirrori.
- **pauza (ndërprerja)**, -është ndalimi i zërit , ndërprerja e ligjërimin për të ndarë fjalët ose fjalitë jo thjesht për nevojë frymëmarrjeje, po për dallim ritmi a kuptimi.
- **përsëritja**, - përsëritja e së njëjtës fjalë disa herë në një varg.
- pretericioni (tejkalimi), kalim përtej, kapërcim pa e përmendur
- **pyetja retorike**, - është një ndërhyrje emocionale në formën e një pyetje që nuk kërkon përgjigje.
- **reticenca (heshtja)**- është përdorimi i tre pikave. Funkcioni i saj është të vërë në mendime lexuesin, apo të theksojë dicka. (në varësi të kontekstit).
- **simploka**.-është figurë e përsëritjes ku kemi përsëritjen në fillim dhe në fund të vargut, pra, simploka është bashkim i anaforës dhe i epiforës.

3. Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve(tropet):

- **alegoria**, - është ajo figurë stilistike me anë të së cilës theksohet një mendim që nuk është shprehur drejtpërdrejtë, por duhet të nënkuptohet
- **antonomaza**, është figurë stilistike që përfitohet duke zëvendësuar një emër të përgjithshëm me një emër të përveçëm, i cili është bërë mishërim i një vetie nga historia, letërsia etj. ose edhe nga anasjelltas, një emër i përveçëm zëvendësohet me një titull, me një togfjalësh, me një epitete etj.
- **asteizmi**, është figura stilistike, me anën e së cilës qortojmë ose shajmë, me qëllim që të lavdërojmë.
- **epiteti**, - fjalët që shërbejnë për të cilësuar e karakterizuar sende, frymore, dukuri që kanë kuptim të figurshëm.
- **eufemizmi**, - realizohet duke zëvendësuar fjalët më të ashpra , të papëlqyeshme me fjalë të buta e të zgjedhura.
- **ironia**, - është pohimi i diçkaje për të nënkuptuar të kundërtën e saj, thënia me seriozitet për të nënkuptuar talljen, përqeshjen, shprehja e dashurisë për të nënkuptuar urrejtjen.
- **katakreza**, -është një lloj metafore, kur përdorim një fjalë a shprehje në rastin kur nuk e ka gjuha një fjalë të zakonshme.
- **metafora**, - është një fjalë a një shprehje e figurshme e cila përcjell veçoritë e ngjashme të një sendi, frymori a dukurie mbi sendin, frymorin a dukurinë që emërton.
- **metonimia**, - është ai lloj tropi me anën e të cilit emri i nje sendi, frymori, dukurie përdoret për të emërtuar një send, frymor a dukuri tjetër, kur ndërmjet tyre ka një lidhje varësie.
- **oksimoroni**, është trop artistik, që nëpërmjet përdorimit të fjalëve me kuptime të kundërta fitohet një përshtypje e re, një kuptim i ri
- **paradoksi**, - është një mendim origjinal i krijuesit që bie ndesh apo në kundërshtim me mendimet e përgjithshme
- **perifraza**, -është një figure stilistike përmes së cilës paraqitet(thuhet) me shumë fjalë ajo që do të mund të thuhej me një fjalë të vetme.

- sarkazmi- shkalla më e lartë. Denoncon, demaskon dhe godet, por bën edhe përgjithësime.
- Sinekdotat- një lloj tropi në themel të së cilës qëndron lidhja sasiore (pjesa për të tërën dhe anasjelltas).

4. Figurat e fjalorit poetik (të leksikut):

- Antonimet-fjalë me kuptim të kundërt
- Arkaizmat-fjalët e vjetra, të cilat kanë dalë nga përdorimi.
- barbarizmat (huazimet)- fjalët e huaja që kanë hyrë në gjuhën shqipe në periudha të ndryshme, nën presionin e pushtimeve dhe kulturës së pushtuesve.
- dialektizmat (krahinorizmat)- janë fjalë karakteristike për një krahinë të caktuar,
- homonimet -janë fjalët e njëjta, por me kuptim të ndryshëm.
- sinonimet –janë fjalët me kuptim të afërt
- neologjizmat-fjalë të reja, që krijohen për të pasuruar gjuhën dhe për ta pastruar atë nga fjalët e huaja.

4. Figurat e sintaksës poetike :

- antimetabola, -është përsëritja e fjalëve në dy pjesë të një fjalisë të përbërë, por në rend sintaksor të përmbytur.
- anadiploza(kapërcimi), është figurë e përsëritjes, ku përsëriten fjalët e fundit të një vargu në fillim të vargut vijues.
- asindetit, - ndërtohet pa i përdorur lidhëzat midis fjalëve e fjalisë.
- elipsa, do të thotë lëshim, fitohet duke këputur , duke hequr apo duke heshtur një pjesë të fjalisë ose të ligjeratës.
- enumeracioni, - numërimi i disa dukurive, fjalëve njëra pas tjetrës.
- gradacioni(shkallëzimi), - sajohet duke renditur dukuritë , idetë, mendimet dhe ndjenjat sipas rëndësisë dhe fuqisë së tyre.
- inversioni, - zhvendosja e fjalës.
- kiazma, -është figurë stilistike që krijohet nga përmbyjsja e gjymtyrëve, nga vendosja e tyre në formë të anasjelltë, por duke ruajtur rendin sintaksor.
- konversioni, -ndërrim, kthesë.
- pleonazmi, -është figura stilistike që përfitohet nga përdorimi i fjalëve të tepërta, me kuptim të njëjtë ose shumë të afërt, duke e forcuar mendimin ose duke e bërë më bindës.
- polisindetit- është e kundërta e asidentit. Ndërtohet duke shtuar numrin e lidhëzave me qëllim ngadalësimi të intonacionit për të shtuar fuqinë shprehëse të fjalës poetike
- tmesi.-në retorikën antike kishte të bënte me ndarjen e një fjalisë të përbërë duke ndërfutur elemente të tjera.Në metrikën latine dhe të disa gjuhëve neolatine kemi të bëjmë me figurën e tmesit kur një fjalë që ndahet në dy pjesë vendoset respektivisht në fund të një vargu njëra pjesë dhe në fillim të vargut pasues pjesa tjetër.

5. Figurat e mendimit:

- **antiteza**, - vënia ballë për ballë e dy cilësive, dy portreteve, dy tablove, dy ideve, dy forcave shoqërore të kundërta për të theksuar e vlerësuar ato për ta bërë sa më shprehës dhe emocional rrëfimin poetik.
- **hiperbola**, - të zmadhuarit ose të zvogëluarit së tepërmi të cilësive dhe të veprimeve e njerëzve ose të dukurive të natyrës për të nxjerrë në pah një ide, një mendim, një cilësi, si dhe për të shprehur më me forcë qëndrimin emocional ndaj jetës që pasqyrohet.
- **krahasimi**, - është të përshkruarit, të karakterizuarit dhe të vlerësuarit e një sendi, frymori a dukurie me anën e një sendi, frymori a dukurie tjetër më të njohur, me të cilën ka lidhje ngjashmërie.
- similituda,
- **litota**, -e kundërta e hiperbolës. Zvogëlon tepër dukurinë, tiparin, veprimin apo ngjarjen.
- **Oksimoroni**- është trop artistik, që nepermjet përdorimit të fjaleve me kuptime të kundërta fitohet një pershtypje e re, një kuptim i ri
- paradoksi.- është një mendim origjinal i krijuesit që bie ndesh apo në kundërshtim me mendimet e përgjithshme

6. Figurat gramatikore (ose liritë poetike) ;

- **Apokopa**, -është rënia e një a më shumë tingujve në fund të fjalës
- **Asindeta**, -ndertohej pa i përdorur lidhezat midis fjaleve e fjalive.
- **Polisindeta**, - është e kundërta e asidentit. Ndertohej duke shtuar numrin e lidhezave me qëllim ngadalesimi të intonacionit për të shtuar fuqinë shprehëse të fjalës poetike
- **Elipsa**, do të thotë lëshim, fitohet duke këputur , duke hequr apo duke heshtur një pjesë të fjalës ose të ligjëratës.
- **Epiteza**, -është shtesa e një tingulli ose e një rrokjeje në fund të fjalës
- **Elizioni**, - është rënia e një zanoreje të patheksuar fundore të një fjale kur ndodhet përpara një zanoreje instore të fjalës pasuese.
- **Inversioni**, - zhvendosja e fjalës.
- **Pleonazma**, -është figura stilistike që përfitohet nga përdorimi i fjaleve të tepërta, me kuptim të njëjtë ose shumë të afërt, duke e forcuar mendimin ose duke e bërë më bindës.
- **Proteza**, -është shtesa e një tingulli në fillim të fjalës.
- **Sinalepsa** dhe
- **Zeugma**.⁹

Klasifikimi i figurave është një proces i vështirë, sepse shumë prej tyre janë të afërta në thelb, prandaj nuk mund të vendosen kufij të prerë. Kështu, një figurë sintaksore nuk dallon shumë nga figura e kuptimit, sepse edhe ajo ka kuptim. Kur flitet për figura të kuptimit, në

⁹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Diskutim:Figura_stilistike

to përfshihen figurat që kanë ndërtim gjuhësor pothuajse të zakonshëm, por japin një kuptim të ndryshëm nga ai i zakonshmi.¹⁰

Siç e pamë, figura stilistike ka shumë por ne do t'i trajtojmë vetëm ato të cilat janë më të përshtatshme, më të pranueshme dhe më të dashura për të vegjëlit. Këtu, në këtë punim, do të shtjellojmë hiperbolën së bashku me litotën, krahasimin, personifikimin, epitetin, onomatopenë, simbolin dhe metaforën.

1.2.1.Hiperbola

Rrjedh nga greqishtja hyperbole-teprim, stërmadhim, është figurë stilistike e stërmadhimit të gjërave a të dukurive. Veçori kryesore e saj është se përmes saj zmadhohet tej mase një send, dukuri, veprim etj nga përmasa e saj e vërtetë. Kjo bëhet me qëllim që të zgjojë fantazinë dhe të nxit te moshat e njoma interesin për të njohur elementet e fantastikës së jetës.¹¹

Justin Rrota thotë: “Hyperbola përbëhet tue zmadhue, ose tue zvoglue sendet deri në tepri. P. sh. E kam qitë më pus të pafund. Fjala mori dhén. Diqa unit. Plasa së xetit. E mbyti së rrahunit. E lau votrën me lot. Ban nji javë me shkue deri në shkallë. Njimijë herë të kam thanë...”¹²

Jakov Xoxa shpjegon: “Në përgjithësi hiperbola është një zmadhim, zmadhim i ndërgjegjshëm i formës ose përmbajtjes së diçkaje, i masës së objekteve, fenomeneve. Them i në përgjithësi pasi hiperbola nuk është vetëm një fenomen letrar artistik. Në poezi, me hiperbolë quajmë një stërmadhim të ndërgjegjshëm të proporcioneve, fuqisë ose kuptimit të një fenomeni, një stërmadhim të formës ose të përmbajtjes së fenomeneve apo sendeve të përshkruara, me qëllim që të na bjerë në sy një veçori inerte e atij fenomeni, njeriu, sendi.”¹³

Ja edhe disa shembuj të hiperbolës:

Fytyra e saj si hana e plotë,
Kjo mollë qenka më e ëmbël se mjalta.
Të kam thënë njëqind herë.

Një hiperbolë e bukur në poezinë tonë për fëmijë:

Kam pasur një gjyshe
mbi të gjitha gjyshet,
kur ajo tregonte,
heshtnin dallëndyshet.
Kur fliste ajo,

¹⁰ <https://www.slideshare.net/ShkumbinMuzlijaj/figurat-letrare>

¹¹ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.107

¹² Justin Rrota, Letratyra shqype për klasët e ulta të shkollave të mjesme, Botimi III, “Fan Noli”, Shkodër, 2006, f. 43.

¹³ J. Xoxa; N. Lezha; P. Kraja. Bazat e teorisë së letërsisë II, “Ars”, Tiranë, 1972, f. 183

mbanin vesh dhe gurët,
thaheshin moçalet,
lulëzonin drurët...

(Odhise Grillo, Balada e burrave të Vunoit)

Përveç hiperbolës, që paraqet zmadhim të tepruar të sendeve, gjërave e të dukurive kemi edhe rastin e kundërt, që është litota e cila paraqet zvogëlimin e sendeve, gjërave dhe dukurive. - **Litota** vjen nga greqishtja *litotes'* - zvogëlim, thjeshtësi.

Litota është e kundërta e hiperbolës dhe autori thotë me pak, duke lënë të kuptohet më shumë. Litota përdoret për modesti, për ndruajtje dhe rrallëherë edhe për ironi. - Shembull nga letërsia artistike: - Kur Skënderbeu kthehet në Krujë, ai i drejtohet kështu komandantit të kështjellës:

- E dini si kam luftuar
- për Sulltan' e për Turqinë
- dhe qysh ai më ka shuar
- vëllezërit e shtëpinë ?!

- S'janë punëra të lehta
- këto që janë punuar,
- dhe nuk rrinë të fshehta
- as janë për të harruar.

(Naim Frashëri - **Historia e Skënderbeut**)

Në vargun "S'janë punëra të lehta" kemi një litotë, sepse me fjalën **të lehta** nënkuptohet e kundërta: **të rënda**. Gjithashtu, edhe në vargun: **As janë për të harruar**, kemi një litotë dhe nënkuptohet: **duhen kujtuar**. Pjesëza zbutëse "as" shërben për t'i dhënë kuptim më të plotë litotës.¹⁴

1.2.2. Krahاسimi

Shkrimtarët për fëmijë e përdorin shpesh këtë figurë, pasi ajo është e përshtatshme jo vetëm për t'u kuptuar, por edhe për t'u përjetuar. Krahاسimi njëherësh zgjon përfytyrimin e objektit me të cilin e krahasojmë. Kështu në botën e fëmijëve aktivizohet imagjinata, ngjallen asociacionet e meditimet për një objekt tjetër, i cili po ashtu ka tiparet e veta, e që fëmija ka mundësi t'i marrë me mend.¹⁵

Lidhur me krahasimin ka definicione të shumta që kanë dhënë shkrimtarë të ndryshëm. Sipas Aleksandër Xhuvanit dhe Kostaq Cipos "krahasimi asht përdorimi i njëj parafytyrimi për ta bamë ma të kthjellët objektin që krahasojnë me të"¹⁶

Sterjo Spasse po ashtu jep përkufizimin "Kemi krahasim atëherë kur për të sqaruar më mirë një frymor, një send, një fenomen apo një ide i vëmë këto përballë

¹⁴ [https://sq.wikipedia.org/wiki/Litota_\(figura_letrare\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Litota_(figura_letrare))

¹⁵ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.112

¹⁶ Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Fillime të stilistikës dhe të letërsisë së përgjithshme, Tiranë, 1930, f.37

frymorëve, sendeve, fenomeneve apo ideve të tjera. Kështu, ai jep krahasimin që i bëhej një vashe të bukur në këngët popullore të ciklit të Mujit dhe të Halilit

E ka qerpikun si krahu i dallëndyshes,

Fytyra e saj kuqet si molla në degë

Goja e vogël si lulja që shpërthen,

Dhëmbët e bardhë si gurzit e lumit

Fill mbas shiut, kur po i shndrit dielli.¹⁷

Krahasimin e kanë praktikuar pothuaj të gjithë krijuesit tanë për fëmijë. Duke pasur parasysh se vepra u kushtohet të vegjëlve, ata kanë pasur kujdes të veçantë që figura po ashtu të ketë natyrë femërore. Nga kjo anë, në shumicën e rasteve, ose objekt i krahasimit, ose edhe ai me të cilin krahasohet, ndërlidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me botën e fëmijëve ose me dukuri të afërta me ta.

Në poezinë për fëmijë, sipas studiuesit Prof. Agim Deva, ky trop paraqitet në dy forma :

- a) Krahasimi emocional. Ky ka për qëllim të vërë lidhje emotive midis objektit themelor dhe atij të përftyruar. Për shembull, Naim Frashëri shkruan :

	Si vëllezër të shkojmë Të ligat t i harrojmë
Asdreni	Shkoi vera Si hije Lart qielli Si plumbi

Poetët për fëmijë e ngrenë më tej emocionalitetin përmes krahasimeve me efekte që janë sa më të afërta për fëmijët. Kështu, Luigj Gurakuqi thotë:

Bashkë ne nandë muej kemi kalue
porsi vllazën n punë e n k ndim.

Vehbi Kikaj	Si yj të natës n qiell Rrezojnë dy sytë e mi.
-------------	--

- b) Krahasimi intelektual. Ky është më i rrallë se i pari. Veç është shumë më funksional, më i pasur për nga kuptimi, më i nevojshëm për fëmijët, sepse vendoset me një mision sqarues e plotësues të koncepteve të ndryshme jetësore. Kështu p.sh Ismail Kadare thotë :

Dhe pranë gurit të vjetër
vihej gur i ri,

¹⁷ Sterjo Spasse, Elementet e para të teorisë së letërsisë, Stilstika poetike, Tiranë, 1964, f.20

siç i vjen veteranit
rekruti përbri.

Ose

Përpara armëve të rrimë
Siç rrimë përpara historisë.¹⁸

1.2.3. Personifikimi

Fjala personifikim rrjedh nga latinishtja persona=person.

Është një nga figurat më të dashura për fëmijët. Me ndihmën e personifikimit, i bën sendet (e jo vetëm ato, por edhe kafshët, shpendët) të mendojnë e të logjikojnë, të debatojnë midis tyre, të veprojnë si njerëz, si persona. Pra, personifikimi ndërtohet kur ndonjë veti e njeriut u vishet kafshëve, bimëve dhe sendeve.

.Shembull :

*Valet me brigje
bajne kuvendime.
(Llazar Siliqi - Mësuesi)*

Në këtë rast përdoret personifikimi, sepse elementet materiale, valët dhe brigjet, paraqiten si qenie të gjalla e me vetëdije dhe që mund të shkëmbejnë mendime¹⁹

Sipas Sterjo Spasse “Personifikimi është një figurë poetike, me anën e të cilës gjënë pa shpirt, kafshët ose edhe idetë i përfytyrojmë si qenie që kanë ndërgjegje edhe ndjenja dhe janë pra të afta për të kryer veprime të arsyetuara. Sipas Spasse, personifikimi ka origjinë shumë të vjetër, që kur njerëzit u drejtoheshin fenomeneve të natyrës me lutje, me përshëndetje, me propozime të ndryshme dhe mendonin se këto fenomene u përgjigjeshin me anën e veprimeve, të ndjenjave ose të fjalës.²⁰

Personifikimi ka mundësi të mëdha komunikuese të cilat janë vërejtur edhe nga poetët dhe shkrimtarët tanë të hershëm, duke filluar nga fabulat e Naimit, të Papa Kristo Negovanit, Çajupit, Ndre Mjedës.

Në veprën “Përralla”, poezia Gjitori i pabesë të Çajupit, thotë:

*Shokë, me vjershat që shkrova
Ngjer sot, për kafshët këndova;
I bëra të kuvendojnë,
Të zihen e të qortojnë,
Kuvendon ujku me qentë,
Peshqit, zogjtë, dhit' e dhentë...*

¹⁸ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f. 112, 113, 114.

¹⁹ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Personifikimi>

²⁰ Sterjo Spasse, Elementet e para të teorisë së letërsisë, Stilitika poetike, Tiranë, 1964, f. 8-9

Në poezinë tonë për fëmijë personifikimi ka shtrirje të ndryshme:²¹

- a) Shtrirje e përgjithshme, kur gjallesat e sendet vetë e fillojnë dhe e përfundojnë një situatë, e cila të shumtën e rasteve zbërthehet përmes konfliktit. Këtu tropi në poezi kap gjithë sipërfaqen strofike, si për shembull tek vjersha e Hilë Mosit *Vaji i zogut*. Në të vërtetë ajo është një monolog i fuqishëm i shpendit në kafaz mbi fatin dhe jetën e vet. Ka shtrirje të përgjithshme personifikuese, sepse të gjitha problemet qenësore të vjershës i takojnë një vetëdijeje që nuk është e njeriut.
- b) Shtrirje e pjeshme, kur vetë fëmijët e krijojnë një rën palë të dialogut personifikues, e palën tjetër e krijojnë gjallesat e sendet. Kështu, në poemën e Aleks Çaçit *Vogëlushja dhe pëllumbi*, pothuaj tërë bukurinë figurative e krijon personifikimi: era kërkon prej piktorit të famshëm Pikaso një zog me të cilin do të fluturojë vogëlushja. Rrezja hyn në dritare, e për fatin e vajzës tregojnë: luleshtrydhja, perdet, ora e murit, shtrati, era, libri i gjeografisë. Megjithatë, në pjesën e dytë të poemës personifikimi zbehet dhe veprimin do ta bartë në supet e veta realiteti jetësor i njerëzimit, që do të thotë se ky trop parcializohet, duke u shfaqur herë pas here në vepër.
Edhe në përrallat e kultivuara veprojnë personazhe kafshë, të cilat, sipas traditës së folklorit, personifikojnë karaktere të caktuara: lepuri-njeriun frikacak; ujku-njeriun e keq, zemërlig, kriminel e gjakatar; dhelpra-njeriun e zgjuar, por tinëzar e dinak; ariu- njeriun babaxhan etj.

1.2.4. Epiteti

Rrjedh nga greqishtja epitheton që do të thotë shtojcë, vënie përsipër.

Është fjalë përcaktuese që i shtohet emrit të një frymori, të një sendi etj, për ta cilësuar e për të vënë në dukje një tipar karakteristik të tij ose për t i dhënë ligjërimin forcë shprehëse e bukuri artistike, emër që i ngjitet dikujt për ta lavdëruar ose për ta fyer.

Në letërsinë tonë për fëmijë, numri i epiteteve është shumë i madh.

Janë dy shtresa të epitetit ²²

- a) Epitete aktive. Këto kanë forcë të madhe frymëzuese, kanë freskinë e intensitetin e duhur estetik, e plotësojnë objektin (emrin ose foljen) jo vetëm nga pikëpamja kuptimore, por edhe stilistike. Naim Frashëri përdor tepër epitetin psikologjik

Janë të mjerë e të gjorë
faqezezë e gënjeshtarë
dhe të paqenë e të marrë
(Tradhtorët)

²¹ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.108,109

²² Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f 114-115

Vehbi Kikaj përdor epitete të tilla si fëmija sypëllumb, çupëza faqekuqe, fushat e trëndafilta etj.

Bekim Harxhi (Ushtari dhe zogu)
 Pastaj mori rrugën
 me zemër të lehtë,
 diku në ahishte u zhduk.

- b) Epitete pasive. Këto nuk janë fort të natyrshëm, shprehja del e vrazhdë, vjersha e poema del e zbehtë. P.sh Kadareja thotë Kërciten fletët e rënda, gjak i kuq skuq në fytyrë, dyllë i verdhë hyri brenda. Këto përdoren në gjuhën e popullit, megjithëse në ligjërimin artistik përbëjnë fjalë të tepërta, parazite, pleonazma.

1.2.5. Onomatopeja

Onomatopeja (gr. onoma – emër dhe poiemo – bëj, krijoj) – është një figurë përmes së cilës imitohen zhurma të caktuara në natyrë, zëra kafshësh ose zëra që na kujtojnë ndonjë send. Imitimi i zërave mund të bëhet në dy mënyra: në mënyrë të artikuluar dhe të paartikuluar. Kështu, kur i përdorim shprehjet bam, fiu, miau, kërc etj, pak a shumë kemi të bëjmë me fjalë të paartikuluara, sepse janë krijuar me imitimin e fjalëpërfjalshëm të natyrës, kurse fjalët shushuris, bubulloj, kakaris etj. tregojnë se këto i ka krijuar njeriu dhe i ka përpunuar në bazë të asaj që ka mundur të dëgjojë në natyrë, por magjithatë i ka ndarë nga imitimi total me atë se ka përdorur zëra të artikuluar, të përcjellë, të përpunuar me intelektin dhe emocionin e tij.²³

Onomatopeja ka forcë kumbuese, imituese, tingëllore dhe zbavitëse e cila krijon pastaj atmosferë të këndshme, gazmore dhe të dashur për fëmijët, të cilët i pëlqejnë shumë këta tinguj prandaj, onomatopeja mbetet ndër figurat më të përzemërta nga grupmoshat më të vogla.

Onomatopeja është shfaqur shumë herët në poezinë tonë, qysh në vjershën e parë “Ylli i vogël lart në qiell” (1872), vargu **xixa, xixa, xixëllon** ka karakter onomatopeik.

Onomatopeja ka dy funksione qendrore :²⁴

1. Si qëllim i vetvetës, ku onomatopeja zë pozitë boshtore dhe ka rëndësi të dorës së parë.

Rexhep Hoxha në këngën e Picimulit dhe bretkës ka ndërtuar strofa vetëm me tinguj onomatopeikë:

Rrap, rrap, rrap, rrap, rrap

Ki, ki, ki, ri, ko!

Rrap, rrap, rrap, rrap, rrap!

²³<https://sites.google.com/view/gjuhë-shqipe-dhe-letërsi-12/studimi-i-let%C3%ABrsis%C3%AB/m-8-figurat-tingullore-dhe-ato-t%C3%AB-diksionit>

²⁴ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.111

Ki, ki, ki, ri, ko !

Kuak: turp!

Kuak kllum!

Kuak kllum!

Kllum! Kllum!

Këto strofa përfaqësojnë në radhë të parë tingëllim onomatopeik.

Me ndihmën e onomatopesë në poezinë bashkëkohore për fëmijë ndërtohen edhe të ashtuquajturat vjersha nonsens, ku, për hir të rimës e të ritmit, ndërfiten e renditen fjalë pa kuptim.

- a) Si përçuese e një ideje të dytë. Këtu onomatopeja ka funksion kalimtar. Ajo përcjell më mirë kuptimin prej vjershës te fëmija dhe ndihmon në realizimin e një ideje të dytë.

Në vjershën e Josip Jelës *Loja* tingujt onomatopeikë ndihmojnë ritmin argëtues, konkretizojnë mënyrën e zhvillimit të lojës:

Shko, ze, luoja! Luoja frk:

Zig, core, miqirrk!...

Ke flijua! Ke gabua!

Un jam, more, tash me lua:

Ara, ara, ara buk....

E para goti: cuk, cuk, cuk!

“Shamarku, - barku”! “Pikë, pik!”

“Lega – belega”.

Onomatopeja është përdorur me sukses si në poezinë tonë për fëmijë po ashtu edhe në prozë, duke luajtur rol të madh në forcimin emocional të vargut, në përforcimin e estetikës tingëllore, respektivisht prania e botës shtazore në prozë ka lindur nevojën që zërat e tyre të paraqiten në mënyrë të posaçme.

1.2.6. Simboli

Kur në vend të emërimit të një sendi përdoret një tjetër, pasi ata kanë lidhje ngjashmërie me njëri-tjetrin, kemi figurën e simbolit.

Sterjo Spasse për simbolin ka dhënë përkufizimin “Simboli është një figurë poetike me anën e së cilës mishërojmë në mënyrë figurative e me shenja konvencionale idetë dhe përfytyrimet tona. Figura stilistike zakonisht nuk përfytyron një përgjithësim personash, ngjarjesh e fenomenesh.²⁵ Pra, është ajo figurë poetike, përmes së cilës nuk e shprehim atë që na prek në zemër por vetëm e ndjejmë.

²⁵ Sterjo Spasse, Elementet e para të teorisë së letërsisë, Stilistika poetike, Tiranë, 1964, f. 12

Simboli është po ashtu ndër figurat më pranishme në letërsinë tonë për fëmijë. Shkrimtari Rifat Kikaj ka përdorur simbolin si figurë për të zgjuar ndjenja të fuqishme emocionale të fëmijët, ku në romanin e vet përshkruan Mirushen dhe Fatosin, personazhe kryesore të cilët janë duke lozur në bregdet, duke ndërtuar kulla prej rëre, mirëpo prindërit e tyre janë duke u ndarë, kështu që Kulla simbolizon harmoninë familjare, dera nga lindja-lumturinë e përhershme, dielli-simbol i fatit të bardhë. Po ashtu, shkrimtari Ymer Elshani simbolin e gërsheton me personifikimin. Skifteri me një sy në roman është simbol i egërsisë, i egoizmit e i mizantropit dhe tiparet e tij reflektohen në një kategori të tërë njerëzish. Edhe peshkaqeni është simbol i karakterit negativ, simbol i tmerrit dhe i rrezikut.²⁶

1.2.7 Metafora

Metafora është një figurë letrare ose retorike që, për të shpjeguar një objekt ose veprim, përdor karakteristikat e një objekti ose veprimit tjetër. Kjo do të thotë, përdor një ngjashmëri për të shpjeguar më mirë idenë që dëshiron të kapë.

P.sh.: *Flokët tuaj janë dielli i mëngjesit.*

"Flokët e tij" do të ishin objekti që ai dëshiron të shpjegojë dhe "ata janë dielli i mëngjesit" është ngjashmëria e përdorur për të thënë se flokët ishin shumë flokëverdhe ose të artë.

Kështu, konceptet e mëposhtme nxirren nga metafora:

- Ndiemoni të shpjegoni një ide duke përdorur një krahasim.
- Nuk duhet të merret fjalë për fjalë (*flokët nuk mund të jenë dielli*), por po në një mënyrë simbolike.
- Përdoren shumë në poezi apo letërsi. Kjo do të thotë që zakonisht synohet të zbkurohet koncepti (*Çdo yll në qiell është një lot që kam qarë për ty*).²⁷

Metafora, të cilën Aristoteli nuk e quan kot mbretëreshë e tropeve, ka kryesisht këto dy origjina:²⁸

1. Metafora e huazuar nga folklori. Kjo ka luajtur rol me rëndësi në vënien e lidhjeve më të nxehta emotive midis veprës letrare dhe lexuesit. Në këtë mënyrë romani, novela e tregimi u janë afruar edhe më tepër fëmijëve, pasi shumë fjalë e fraza të natyrës metaforike, i kanë dëgjuar edhe më pare në familje e shoqëri, e tani i gjejnë edhe në veprat e shkrimtarëve tanë. Si e tillë, metafora lot edhe efektin e duhur psikologjik. Për shembull: *Një ditë prej ditësh Shpendi e ban zemrën gur...* (R. Hoxha, *Lugjet e verdha*); *Me frikë asgja nuk arrihet* (po ai); *Oh, të paska*

²⁶ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.118

²⁷ <https://sq.warbletoncouncil.org/metafora-ejemplos-3279>

²⁸ Astrit Bishqemi, Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004, f.117,118

harrue syni, por jo zemra, djali im (Vehbi Kikaj, Sarajet e bardha) etj. Këto jo vetëm e freskojnë, por edhe e thellojnë mendimin.

Nuk janë të rralla në prozën tone edhe metaforat e tipit sentencial.

Krahas qëllimit edukativ, ato kanë edhe karakter të caktuar mësimor.

2. E përhapur është metafora origjinale (e krijuar nga vetë shkrimtarët):

Gëzimi yt po e zgjueka nganjëherë hidhërimin e tjetrit (V. Kikaj, Sarajet e bardha);
Ëndrra për pasuri nganjëherë ia mbyll njeriut veshët (po ai);
Besimi i mban njerzit dhe i ban të fuqishëm (po ai).

Ose:

*Ata pranë shkollave u bien fort borive
dhe marrin me vete buzëqeshjen e fëmijëve*

(Hamdi Meça, Shoferët e kromit)

Ja edhe një strofë nga poeti Ferit Rama, ku metaforat-folje e japin ndjeshëm shqetësimin e prindit për djalin refugjat:

*Ç'më je nisur, biro
udhëve të gjata...
ku të zbulon dita,
ku të mbulon nata;
ku të miklon hija,
ku të zhurit vapa.
Ç'më je nisur biro, udhëve të gjata!*

2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1 Dizajni hulumtues

Ky hulumtim është hulumtim kuantitativ,qëllimi dhe rëndësia e të cilit qëndron në faktin e vlerësimit të njohurive të nxënësve lidhur me figurat stilistike,kureshtjen që ata kanë për të mësuar këto figura si dhe preferencat e tyre ndaj këtyre figurave.Qëllimi i kësaj është për të parë nga afër se si ata kanë arritur t'i përvetësojnë këto figura dhe si arrijnë ti dallojnë ato.

Objektivat e këtij punimi kanë të bëjnë me marrjen e informacioneve të nevojshme për figurat stilistike për fëmijë të cilat i kanë të njohura dhe arrijtjet për ti dalluar në bazë të shembujve që kam trajtuar.

2.2.Pjesëmarrësit

Në këtë hulumtim të dhënat janë mbledhur përmes pyetësorëve të plotësuar nga nxënësit.Popullacion i këtij hulumtimi janë nxënësit e klasave të pesta,në qytetin e Vushtrrisë,gjithsej 102 nxënës(48 femra dhe 54 meshkuj).Mostra e këtij hulumtimi janë 40 nxënës(18 femra dhe 22 meshkuj) e cila është përcaktuar duke u bazuar në mostrën e rastësishme.Pra,ky hulumtim është realizuar duke përdorur mostrën rastësore.Popullacioni i këtij studimi është përbërë nga të gjithë nxënësit e klasave të V-ta të shkollës fillore SH.F.M.U “Ali Kelmendi” në qytetin e Vushtrrisë.

2.3 Pyetjet e hulumtimit

- Sa interesante është për këta nxënës të mësuarit e këtyre figurave?
- Si kanë arritur t'i dallojnë këto figura?

2.4.Instrumentet

Mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim e kam realizuar përmes pyetësorit,si një instrument mjaft i suksesshëm për hulumtim.Ky pyetësor përmban gjithsej 9 pyetje dhe është i formuluar për nxënësit e përzgjedhur.Pyetësori përmban pyetje demografike në lidhje me moshën gjininë, klasën dhe shkollën.Poashtu përmban pyetjet që lidhen me studimin në fjalë për të arritur deri tek konkluzionet se cilat figura stilistike pëlqejnë këta nxënës.

2.5.Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat për këtë hulumtim janë mbledhur në qytetin e Vushtrrisë,kryesisht në shkollën SH.F.M.U “Ali Kelmendi”,të cilat i kam realizuar unë,Xhenete Haziri,me nxënësit e klasave të V-ta.Nxënësit plotësuan pyetësorin në prani të mësimitdhënësës.Mbledhja e të dhënave u bë me lejen e Drejtorisë së Arsimit,drejtorit të shkollës dhe mësimitdhënësit të klasës.Mbledhja e të dhënave është realizuar me 22 mars,2021.

2.6 Analizat

Pjesë e këtij procesi ishte krijimi i databazës me të dhënat e grumbulluara, si dhe përpunimi dhe analiza e tyre, të cilat u realizuan përmes programit statistikor softuerik SPSS. Analiza e të dhënave është kryer nëpërmjet analizës deskriptive dhe analitike.

Me analizën deskriptive përshkruam karakteristikat e pjesëmarësve si të moshës, gjinisë, klasës dhe shkollës. Përveç kësaj, në studim është përdorur edhe T-test ku me anë të këtyre analizave statistikore kemi analizuar dhe nxorrëm rezultate duke u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore.

2.7. Aspekti etik


Fillimisht, nxënësit u njoftuan për punimin, qëllimin e tij dhe rëndësinë e të përgjigjurit në mënyrë të sinqertë dhe reale. Procesi u realizua në praninë e mësimit dhe të klasave përkatëse ku unë jipja shpjegimet, sqarimet e nevojshme për mënyrën se si duhej plotësuar pyetësi dhe se çka kërkohet nga ata. Gjithashtu, pyetësi ishte anonim, i cili përmbante shkollën, klasën dhe gjininë. Askush nuk ka pasur qasje në të dhënat që përmbante pyetësi. Ky pyetësor u realizua me lejen e Drejtorisë së Arsimit, drejtorit të shkollës dhe mësimit dhe të mësimit.

2.8. Kufizimet e hulumtimit

Kufizimi i këtij hulumtimi është se rezultatet e fituara nga ky studim janë mbledhur vetëm në shkollën “Ali Kelmendi” përkatësisht klasat e pesta; V-1, V-2 dhe V-3 në Vushtrri, prandaj përfaqësojnë një grup të vogël të nxënësve dhe si e tillë nuk mund të merret në mënyrë të përgjithësuar për tërë komunën e Vushtrrisë apo për Kosovën.


3.REZULTATET E HULUMTIMIT

Të dhënat e mëposhtme paraqesin rezultatet e nxjerra nga analizat e bëra në programin Excel(2013) për figurat stilistike se sa janë ato të njohura për nxënësit e klasave të pesta,si kanë arritur t'i përvetësojnë dhe sa arrijnë t'i dallojnë.




Grafiku 1. Cilat nga figurat stilistike i njihni?

Të dhënat statistikore,bazuar në përgjigjet e nxënësve tregojnë se ata njohin metaforën,për të cilën janë dhënë 17 përgjigje,28për hiperbolën,17 për epitetin,18 për krahasimin,13 për onomatopenë,16 për personifikimin dhe 14 për simbolin.




Grafiku 2.Si arrini t'i dalloni figurat stilistike?

Bazuar në të dhënat e grafikut 2 ,në pyetjen se si i dallojnë figurat stilistike,rezultojnë se 72% e nxënësve ose 29 nxënës arrijnë t'i dallojnë mesatarisht figurat stilistike,25% e nxënësve ose 10 nxënës arrijnë t'i dallojnë me lehtësi dhe 3% e tyre ose 1 nxënës i dallojnë me vështirësi.




Grafiku 3.Si keni arritur t'i përvetësoni këto figura?

Në pyetjen se si keni arritur t'i përvetësoni këto figura ,32 nxënës ose 80% janë përgjigjur se ata kanë arritur t'i përvetësojnë nga shpjegimi dhe bashkëpunimi me mësuesen,4 prej tyre ose 10% përmes punës grupore dhe poashtu 4 nxënës ose 10 % kanë arritur t'i përvetësojnë nga puna individuale.



Grafiku 4.Sa interesante i'u duken figurat stilistike?

Sa i përket pyetjes: Figurat stilistike më duken.....31 nxënësve i'u duket interesante për t'i mësuar figurat stilistike ose shprehur në përqindje 77 % ,mesatarisht interesante për t'u mësuar iu duken 7 nxënësve ose 18 % ,ndërsa aspak interesante për t'u mësuar iu duken 2 nxënësve ose 5 %.




Grafiku 5.Në vargun: mjau, mjau macja bënte,kemi këtë figurë :

Të dhënat e grafikomit tregojnë se 38 nxënës janë përgjigjur saktë në pyetjen “ Në vargun mjau,mjau bënte macja,kemi këtë figurë,pra onomatopenë ose 95 %, ndërsa për metaforën janë përgjigjur 2 nxënës ose 5 %,përgjigja e t ë cilëve nuk është e saktë.




Grafiku 6.është figura stilistike,me anë të së cilës sendit apo kafshës i vishen tiparet e njeriut ,gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz.

Në pyetjen “...është figura stilistike ,me anë të së cilës sendit apo kafshës i vishen tiparet e njeriut,gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz” 29 nxënës ose 72 % janë përgjigjur saktë ,pra personifikimi, 18 % ose 7 persona kanë zgjedhur epitetin, ndërsa për krahasimin janë përgjigjur 4 persona ose 10%.



Grafiku 7. 7.Syni i saj si kokrra e qershisë.Këtu kemi të bëjmë me:

Duke u bazuar në rezultatet e grafikut 7,rezulton se 27 nxënës ose 67 % e kanë kuptuar siç duhet figurën e krahasimit duke u përgjigjur saktë në pyetjen e parashtruar që lidhet pikërisht me të,9 prej tyre ose 23 % janë përgjigjur për hiperbolën dhe 4 nxënës ose 10 % janë përgjigjur për metaforën.




Grafiku 8. Kam kaluar shtatë bjeshkë për të ardhur gjer këtu.

Skënderbeu rrëmbeu shpatën sikur të ishte një pend.

Këtu bëhet fjalë për :

Nga shembujt e dhënë në pyetjen e 8, nxënësit janë përgjigjur saktë për hiperbolën 28 prej tyre, për simbolin 9 nxënës dhe për onomatopenë 3 nxënës.



Grafiku 9. Cilat figurat stilistike iu pëlqejnë më shumë?

Nga të dhënat e grafikut në pyetjen se cilat figura stilistike pëlqejnë më shumë rezultojnë se hiperbola, krahasimi, onomatopeja dhe personifikimi janë figurat që pëlqehen më shumë nga ata.

4.DISKUTIME

Në këtë kapitull do të paraqes rezultatet e fituara në këtë hulumtim rreth veçorive të figurave stilistike.

Hulumtimi im është realizuar mbi bazën e dy pyetjeve të parashtrura.Pyetja e parë është:“Sa interesante është për këta nxënës të mësuarit e këtyre figurave”, ndërsa pyetja e dytë është

“Si kanë arritur nxënësit t’i dallojnë këto figura”,

Me anë të pyetësorit të shfrytëzuar kam ardhur në përfundim se shumica dërrmuese e nxënësve,përkatesisht 31 nxënës ose 77% prej tyre janë shprehur se figurat stilistike janë interesante për t’u mësuar pasi që ato i pasurojnë veprat me kuptime të figurshme që janë të dedikuara posaçërisht për fëmijë,duke i bërë ata të jenë më kureshtarë dhe të kenë imagjinatë me të thelluar.

Ndërsa, sa i përket pyetjes së dytë se sa ata arrijnë t’i dallojnë këto figura,pas përpunimit të rezultateve kemi ardhur në përfundim se shumica e nxënësve arrijnë mesatarisht t’i dallojnë këto figura sado që ato iu duken interesante.Në këtë ka ndikuar ose pengesë për arritjen e këtij qëllimi ka qenë situata me Covid-19 si pasojë e të cilës ka pasur raste kur shkollat janë mbyllur kur në shkollë janë paraqitur raste të infektimit me Covid-19 nga ana e mësimitdhënësve por edhe nga ana e nxënësve.Kjo situatë me pandeminë ka bërë që mësimi të zhvillohet me orar të shkurtuar dhe si rezultat i kësaj,nxënësit nuk kanë arritur t’i përvetësojnë këto figura sa duhet.

5.PËRFUNDIME

Ky hulumtim, *Veçori të figurave stilistike për fëmijë*, është një hulumtim mbi qëllimin e kuptimit se sa figurat stilistike janë të njohura për nxënësit e klasave të pesta,sa ata janë të interesuar të mësojnë dhe të dinë për to,si kanë arritur t'i përvetësojnë dhe sa arrijnë të bëjnë dallimet në mes tyre të paraqitura përmes shembujve konkretë.

Duke u bazuar në të dhënat e pranuar nga pyetësi dhe nga literatura e shqyrtuar për realizimin e këtij hulumtimi,arrijmë në këto përfundime:

- Për përvetësimin e këtyre figurave është shumë e rëndësishme aplikimi i teknikave të ndryshme,sepse lehtëson të nxënit dhe ndihmon në arritjen sa më të shpejtë të të kuptuarit.

-Si element i rëndësishëm në këtë hulumtim doli të jetë mësimdhënësi, i cili luan një rol shumë të rëndësishëm në përvetësimin e këtyre figurave nga nxënësit.Komunikimi mësues-nxënës është i shkallës së lartë.

-Nxënësit kanë shprehur edhe interesimin e madh që kanë për të mësuar rreth këtyre figurave stilistike.Megjithatë, ka ngecje sa i përket dallimit të këtyre figurave në bazë të shembujve të dhënë.

-Si përfundim,figurat stilistike më të pëlqyera për nxënësit e klasava të pesta janë hiperbola,personifikimi,onomatopeja dhe krahasimi si ndër figurat më kumbuese,gazmore e tingëlluese për mënyrën se si ato arrijnë t'i pasurojnë posaqërisht veprat për këto grupmosha.

6.REKOMANDIME

Për arsye të mostrës jo-gjithëpërfshirëse në tërë Komunën e Vushtrrisë rekomandohet që në të ardhmen të bëhen hulumtime me mostër edhe më të madhe, duke përfshirë një numër sa më të madh të nxënësve e po ashtu edhe të shkollave. Gjithashtu, përveç pyetësorit të përdoren edhe instrumente tjera matëse. Rekomandohet që nxënësit në bashkëpunim me mësuesen, të punojnë më shumë në arritjen e qëllimit, pra në zotërimin e këtyre figurave e deri të arrijnë t'i dallojnë këto figura nga njëra-tjetra. Mësuesja të shfrytëzojë teknikat më efektive të mësimdhënies në mënyrë që nxënësit të arrijnë t'i përvetësojnë këto figura, po ashtu nga nxënësit kërkohet edhe punë individuale e grupore dhe të tregohen më të kujdesshëm dhe më të angazhuar gjatë mësimit të këtyre figurave.

LITERATURA

Bishqemi. Astrit , Teoria e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 2004

Demiri-Frangu. Qibrije, Letërsia për fëmijë, Prishtinë, 2011

Spasse. Sterjo, Elementet e para të teorisë së letërsisë, Stilstika poetike,Tiranë,1964

Xhuvani. Aleksandër,Cipo. Kostaq, Fillime të stilistikës dhe të letërsisë së përgjithshme, Tiranë, 1930

Agim Vinca, Panteoni i ideve letrare. “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2002

Dr. Hamiti. Asllan, Dr. Neziri. Zeqirja, Dr.Leka. Agim,Gjuhë shqipe dhe letërsi,Shkup,2005

Rrota.J, Letratyra shqype për klasët e ulta të shkollave të mjesme, Botimi III, “Fan Noli”, Shkodër, 2006

J. Xoxa; N. Lezha; P. Kraja. Bazat e teorisë së letërsisë II, “Ars”, Tiranë, 1972, f. 183

<https://tradita.org/2020/02/14/rrjedhave-te-letersise-bashkekohore-shqipe-per-femije/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Diskutim:Figura_stilistike

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Litota_\(figura_letrare\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Litota_(figura_letrare))

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Personifikimi>

<https://sq.warbletoncouncil.org/metafora-ejemplos-3279>

<https://sites.google.com/view/gjuh-shqipe-dhe-letrsi-12/studimi-i-let%C3%ABrsis%C3%AB/m-8-figurat-tingullore-dhe-ato-t%C3%AB-diksionit>

<https://www.slideshare.net/ShkumbinMuzlijaj/figurat-letrare>

SHTOJCA

Pyetësor –

Figurat stilistike

Shkolla:

Klasa:

Gjinia: a) Femër b) Mashkull

Mosha:

1. Cilat nga figurat stilistike të mëposhtme stilistike I njihni:

- a) Personifikimi b) Metafora c) Epiteti d) Krahasimi e) Simboli
f) Hiperbola g) Onomatopeja

2. Si keni arritur t'i përvetësoni këto figura:

- a) Nga puna individuale
b) Nga puna grupore
c) Nga shpjegimi dhe bashkëpunimi me mësuesen

3. Figurat stilistike i dalloj:

- a) me lehtësi
b) me vështirësi
c) mesatarisht

4. Figurat stilistike më duken :

- a) interesante për t'u mësuar
b) mesatarisht interesante për t'u mësuar
c) aspak interesante për t'u mësuar

5. Në vargun :” Mjau, mjau macja bënte , kemi këtë figurë:

- a) metaforë
- b) Onomatope
- c) Hiperbolë

6. _____ është figura stilistike ,me anë e së cilës sendit apo kafshës I vishen tiparet e njeriut gjërat pa shpirt e pa vetëdije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz.

Kjo figurë është:

- a) Personifikimi
- b) Epiteti
- c) Krahasimi

7.Syni I saj si kokrra e qershisë. Këtu kemi të bëjmë me figurën stilistike të:

- a) Hiperbolës
- b) Krahasimit
- c) Metaforës

8.Kam kaluar shtatë bjeshkë për të ardhur gjer këtu .

Skënderbeu rrëmbeu shpatën sikur të ishte një pendë.

Këtu bëhet fjalë për :

- a) Hiperbolën
- b) Simbolin
- c)Onomatopenë

9.Figurat stilistike që më pëlqejnë më shumë janë: _____